



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 1206/2 prot

Gramsh, më 26 02.2019

**Vendim**

Nr. 18, dt. 25.02.2019

**Për**

**Për miratimin e sistemimit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit.**

Bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social” neni 15,,të ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015,”Për vetëqeverisjen vendore”,neni 8,pika 2;neni 24,pika 2,të relacionit të drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencave civile,këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të datës 25 02.2019

**V e n d o s i:**

- I. Miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit,sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Kriteret	Shkalla e vlerësimit
<b>a</b>	<b>Kushtet e strehimit</b> , në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:	<b>20</b>
	i) nuk disponojnë banesë në pronësi;	5
	ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;	3
	iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	3
	iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	3
	v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	3
	vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	3
<b>b</b>	<b>Kushtet familjare</b> , në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:	<b>10</b>
	i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	3

	ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	3
	iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;	2
	iv) bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.	2
<b>c</b>	<b>Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:</b>	<b>40</b>
	i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	6
	ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;	6
	iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve;	0
	iv) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;	1
	v) familjet e policëve të rënë në detyrë;	3
	vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);	3
	vii) punonjësit e repartit RENEA;	2
	viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	2
	ix) viktimat e dhunës në familje;	3
	x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;	3
	xi) anëtarët e komunitetit rom;	3
	xii) anëtarë të komunitetit egjiptian;	2
	xiii) të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;	2
	xiv) vajzat nëna;	2
	xv) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.	2
<b>d</b>	<b>Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj.</b>	<b>30</b>
	i) Familje me të ardhura shumë të ulëta	15
	ii) Familje me të ardhura të ulëta	10
	iii) Familje me të ardhura mesatare	5




**Shënim** :Për familjet që do të klasifikohen me pikë të barabarta do të kenë prioritet familjet me numër më të madh pjestarësh.

- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtorja e shërbimeve publike dhe emergjencat civile, sektori i shërbimeve sociale.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**Astrit DUZHA**



Konc. dak. A. Duzha   
Pranoi :Sh.Hoxha   
Konfirmoi Sh.Hoxha   
Dosja nr. \_\_\_\_\_  
Afatí \_\_\_\_\_



**Kryetari i Këshillit të Bashkisë**

**Shkëlqim HOXHA**

